

## **Kryetari dhe zv. Kryetarët**

*Zgjedhja e Kryetarit*

*Përgjegjësitë e Kryetarit*

*Shkarkimi i Kryetarit*

*Udhëheqja Ekzekutive Komunale*

*Shërbimi Civil Komunal*

## **ZGJEDHJA E KRYETARIT**

Kryetari i komunës zgjedhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale.

Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare. .

## **PËRGJEGJËSITË E KRYETARIT**

Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikqyr administrimin financiar të komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
- e) emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;

- f) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin e komunës;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës; dhe
- k) mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cënon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
- l) do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin joshumicë; dhe
- m) Aktivitetet tjera që i caktohen me statut.

Siç shihet, pra, kryetarët e komunave emërojnë drejtorët e drejtorive, kryesojnë bordin e drejtorëve, menagjojnë dhe propozojnë buxhetin vjetor të

komunës, përgjegjësi këto të cilat gjer më tani kanë qenë në kompetencë të kryeshefit ekzekutiv.

## **SHKARKIMI I KRYETARIT**

Kryetari i komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 ditëve, nëse kryetari ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi;

Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra të kryetarit të komunës, ministria përgjegjëse për pushtet lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e atij kryetari. Qeveria e Republikës së Kosovës (brenda 30 ditëve) mund të suspendojë me vendim kryetarin e komunës dhe t'i dorëzojë lëndën gjykatës kushtetuese.

Nëse gjykata kushtetuese e përkrah vendimin. Qeveria mund shkarkojë nga detyra kryetarin.

## **MANDATI I KRYETARIT TE KOMUNES**

Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

a) kur ta kryejë mandatin e tij;

b) nëse vdes;

c) nëse jep dorëheqje;

d) nëse ndrron vendbanimin në komunë tjetër;

e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;

f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;

g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e

komunës nga cilësia juridike;

dhe

h) në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

### **NËNKRYETARI I KOMUNËS**

Në çdo komunë, Kryetari i Komunës ka një nënkryetar.

Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

Me kërkesë të kryetarit, Nënkryetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

### **Nënkryetari i Komunës për Komunitete**

Komunat ku të paktën 10% e banorëve i përkasin komuniteteve jo-shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete.

Nënkryetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetari.

Emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit për Komuniteteve propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e

anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve joshumicë.

Nënkryetari për komunitete do t'i ndihmojë kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

Kur posti i nënkryetarit për komunitete mbetet i lirë, kryetari propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë

### **UDHËHEQËSIA KOMUNALE / EKZEKUTIVI**

Kryetari i komunës, nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive komunale janë pjesë ekzekutive Komunale.

Përgjegjësitë e Kryetarit, nënkryetarit u spjeguan më lartë, ndërsa, në vijim do të përqendrohemi në stafin tjetër ekzekutiv ( drejtorët ) dhe zyrtarët tjerë civil.

### **DREJTORITË KOMUNALE**

Në bazë të Statutit komunal themelohen drejtoritë komunale të cilat përfshijnë:

Drejtorinë e administratës dhe personelit, Drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Drejtorinë e arsimit dhe kulturës, Drejtorinë e financave, ekonomisë dhe zhvillimit, Drejtorinë e urbanizmit, kadastrës dhe mbrojtjes

së mjedisit, Zyrën komunale për komunitete dhe ndonjë drejtori tjetër që konsiderohet e nevojshme dhe e duhur për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të komunës.

Kryetari emëron drejtorin për secilën drejtori në pajtim me nenin 27, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe udhëheqjen e drejtorisë komunale, përveç Drejtorisë së administratës dhe personelit, e cila funksionon nën drejtimin dhe udhëheqjen e shefit të Drejtorisë nën autorizimet e përgjithshme të kuvendit komunal dhe të kryetarit.

Një drejtori mund t'i caktohet përgjegjësia për të udhëhequr më shumë se një (1) drejtori.

Drejtorët janë të emëruar politik për mandat të njëjtë me kryetarin e komunës dhe konsiderohen “të emëruar të lirë”. Secila drejtori komunale që përbëhet nga shërbyes civil komunalë e ka një drejtues të punësuar në përputhje me ligjin në fuqi mbi shërbimin civil në Kosovë.

## **Bordi i drejtorëve**

Bordi i drejtorëve përbëhet prej drejtorëve të emëruar nga kryetari, nga drejtuesi i Drejtorisë së administratës dhe personelit dhe nga drejtuesi i Zyrës për komunitete, të cilët shërbejnë si anëtarë sipas detyrës zyrtare:

Secili anëtar i Bordit të drejtorëve, duke përjashtuar anëtarët sipas detyrës zyrtare, i:

- (a) raporton rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tij;
- (b) ndihmon kryetarit, kuvendit komunal dhe komiteteve të tij duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes
- (c) zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e komunës.

## **Administrata komunale organizohet në drejtorate.**

Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari.

Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Në baze të konstatimeve të lartpërmendura, mund të konkludohet me sa vijon :

- Rekrutimi në shërbimin civil nuk duhet të ketë nuanca politike dhe/ose të ndikohet nga arsye politike. Procedurat e rekrutimit duhet të aplikohen në mënyrë transparente.
- Transparenca në procesin e rekrutimit është thelbësore nëse komunat dëshirojnë të kenë besimin e qytetarëve në këtë sistem.
- Bordi i Pavarur Mbikëqyrës duhet të punojë në mënyrë efikase për mbrojtjen e shërbyesve civilë dhe duhet të monitorojë procesin e rekrutimit për të garantuar neutralitet dhe transparencë.